

**31.03.2023
Ora 14:10**

RENDI I DITËS

**Shorti për caktimin e relatorit të kërkesës ankimore nr. 41, me ankues Partia
Aleanca Maqedonase për Integrimin Europian.**

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. E. Lako, Z. F. Çefa, Z. I. Rusmali, Z. K. Bele, Z. I. Braho
- **Stafi i KQZ:** Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmanaj, E. Mema

Z. K. Bele: Mirëdita të gjithëve, mirë se keni ardhur! Po çelim seancën e sotme. Për procedurë, meqenëse kemi shortin për të hedhur, fillojmë njëherë me shortin dhe pastaj vijojmë me seancën e rradhës të orës 14:00 që është shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 40, seancë kjo e planifikuar. Vijojmë me shortin e kërkesës ankimore nr. 41, sipas procedurës, faleminderit!

Z. Y. Merkaj: Atëherë, faleminderit! Përshëndetje të gjithëve! Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur kërkesa ankimore nr.41, me ankues Partia Aleanca Maqedonase për Integrimin Europian, e cila ankimon mosvendimmarrjen e KZAZ-së nr. 71, Bashkia Pustec, për regjistrimin e listave shumemërore për kandidatë për anëtarë të këshillit bashkiak të Bashkisë Pustec, të kësaj partie. Procedura e shortit parashikohet në nenin 14 të rregullores së KAS-it. Për këtë kemi përgatitur 5 shirita letre, ku në një është shënuar kërkesa ankimore nr. 41, shiritat e tjerë janë të bardhë dhe pa shënime. Të gjithë shiritat pasi palosen do të futen në 5 gogla me peshë, ngjyrë dhe formë të njëjtë, në një enë transparente. Duke qenë se anëtarët e KAS-it janë prezent, kanë autorizuar një përfaqësues të KQZ-së për të tërhequr në emër dhe për llogari të tyre goglat për caktimin e relatorit të kërkesës

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.31.03.2023*

ankimore nr. 41. Do të fillojmë tërheqjen e goglave sipas rëndit alfabetik rritës. Duke filluar nga zoti Elvin Lako. Pasi prazjehen goglat:

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Elvin Lako - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Elvis Çefa – Kërkesa ankimore nr. 41


Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Ilirjan Rusmali - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Koli Bele - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Ledio Braho – Shiriti është i bardhë dhe pa shënime

Në përfundim të procedurës së shortit, relator i kërkesës ankimore nr. 41, është caktuar zoti Elvis Çefa. Ju faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



RENDI I DITËS

Projektakti "Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 40, datë 30.03.2023 të z. Mehmet Nelaj me objekt " Kundërshtim i vendimit nr.17, datë 27.03.2023, të KZAZ nr. 90 , Sarandë".


PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Ilirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Z. E. Mema, Znj. I. Osmanaj
- **Parti Politike:**
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. K. Bele: Deklarojmë të çelur seancën e sotme për shqyrtimin në themel të çështjes ankimore nr.40, depozituar në datën 30.03.2023 nga Mehmet Nelaj me objekt kundërshtimin e vendimit nr.17 në datë 27.03.2023 të KZAZ-së nr.90, për ndryshimin e vendimit për të vendosur pranimin si kandidat për Këshillin Bashkiak Sarandë për zgjedhjet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023. Sipas shortit të hedhur relatori kësaj çështje jam unë Koli Bele. Palët prezente këtu KAS është mbledhur me 5 anëtarët e tij, gjithashtu administrata e KQZ-së e përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm. Nuk kemi palë të interesuara prezent?

Z. Y. Merkaj: Janë njoftuar po nuk kanë ardhur.

**Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.31.03.2023*

Z. K. Bele: Janë njoftuar, në rregull. Në këtë fazë në mungesë të palëve nuk ka kërkesa paraprake. Vazhdojmë me Sekretarin e Përgjithshëm shkurtimisht elementët e çështjes.

Z. Y. Merkaç: Referuar kërkesës drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nga zoti Mehmet Nelaj. Ju parashtojmë se kandidati për anëtarë të Këshillit Bashkiak Sarandë, ka depozituar dokumentacionin 68 ditë përpara ditë zë zgjedhjeve domethënë 50 ditë para ishte ajo domethënë 16 ditë përpara hapjes së dorëzimit të dokumentacionit. Gjithmonë duke iu referuar kërkesës që ka dorëzuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ne e kemi marrë kërkesën dhe dokumentacionin. Gjatë kësaj periudhe ka shkuar në Turqi ku është operuar dhe ka ardhur në datën 03.03.2023 në Shqipëri, në Sarandë. Është paraqitur pranë KZAZ-së ku ka depozituar edhe aty kërkesat sipas formatit të vjetër pasi ka qenë, zotëron një mandat në Këshillin e Bashkisë Sarandë, i është referuar dokumentacionit të miratuar për zgjedhjet e vitit 2019. KZAZ Sarandë me arsyetimin se dokumentacioni është model i vjetër dhe duhet të kishte ngritur komitet nismëtar për paraqitjen e kandidaturës së tij ai anëtar i Këshillit Bashkiak, referuar nenit 70 pika 3 të Kodit Zgjedhor i ka kthyer dokumentacionin dhe i ka thënë është i pa saktë. Në datën 27.03 ka dorëzuar dokumentacionin sipas formatit modelit të ri. 27.03 gjithmonë duke iu referuar kërkesës së ankuesit. Brenda afatit.

Z. K. Bele: Këtu konstatojmë që ka një komunikim të administratës të KQZ-së e relatojmë me KZAZ-në nr. 90 ku janë njoftuar për çështjen dhe ata kanë shpjeguar qëndrimin e mbajtur nga ana e tyre në lidhje me regjistrimin, duke mbajtur të njëjtin qëndrim që shpjegoi edhe Sekretari i Përgjithshëm pasi sqarojmë se e kanë të pamundur të vijnë dhe mos regjistrimin e zotit Mehmet Nelaj si kandidatë i

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.31.03.2023*

propozuar nga zgjedhësit për këshill bashkiak ka ndodhur për arsye se nuk është rregjistruar komiteti nismëtar sipas përcaktimeve ligjore brenda datës 06.03. Pra, konflikti këtu në thelb është i thjeshtë dhe ka të bëjë interpretimin e nenit 70 pika 4 dhe pika 3 ku flitet për momentin e krijimit të komitetit nismëtar sipas nenit 70 pika 3 për paraqitjen e kandidatit nga zgjedhësit duke krijuar komitet nismëtar jo më pak se 9 zgjedhës nga zona zgjedhore e cila ka ngarkuar mbledhjen e firmave mbështetëse për kandidatin jo më vonë se 70 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Komiteti Nismëtar regjistrohet në KZAZ dhe elementë të tjerë. Kandidati, neni 4 ndërkaq specifikon kandidatët e propozuar nga zgjedhësit përjashtohen nga detyrimi pra i cituar në pikën 3 të këtij neni nëse janë kryetar bashkie, anëtar të këshillit të njësisë të qeverisjes vendore përkatëse ose deputet. Pra, kërkohet vërtetimi me shkrim nga institucioni përkatës. Nga verifikimi i praktikës rezulton që akte të tilla janë. Unë kisha vetëm një pyetje zoti Merkaj nëse ju jeni në dijeni dhe mund ta konfirmoni në zgjedhjet e mëparshme apo në rastet e ngjashme si është proceduar? Pasi kjo dispozitë është e vitit 2012 pra nuk kemi një ndryshim ligjor si në disa raste të tjera.

Z. Y. Merkaj: Në vitin 2015 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka mbajtur të njëjtin qëndrim këtë që po mbajmë sot ndërsa në vitin 2019 duke qenë se zgjedhjet ishin pak jo standartit pasi mungonte opozita, janë pranuar edhe pa komitet nismëtar..

Z. K. Bele: Në vitin 2019 që zgjedhjet kanë qenë më të reklaksuara ka ecur praktika. Në rregull, unë nuk kam ndonjë pyetje tjetër nuk e di kolegët a kanë ndonjë pyetje në këtë fazë.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.31.03.2023*

Z. I. Rusmali: Ju na folët për praktikën, kuadrin rregullator na e shpjegoni dot? Në vitin 2015 ka pasur vendime, udhëzime, që përcaktonin që duhet të kalojnë nëpërmjet komitetit nismëtar dhe vitin 2019 u modifikuan këto.

Z. Y. Merkaj: Nuk kemi pasur asnjë gjë më të shkruar thjesht ka qenë një arsyetim i komisionit dhe kanë qenë orientime verbale.

Z. I. Rusmali: Në rregull orientime verbale mbi këtë dispozitë, dispozitën e nenit 70 jo se ka pasur të tjera. Në rregull.

Z. K. Bele: Nëse nuk kemi ndonjë pyetje? Nuk kemi. Krijohet bindja në këtë fazë që kandidati ka bërë përpjekje të mjaftueshme dhe përtej se çfarë i kërkohej. Ju lutem Sekretar i Përgjithshëm qëndrimin tuaj përfundimtar lidhur me sa u diskutua?

Z. Y. Merkaj: Siç argumentova edhe më parë ne kërkojmë rrëzimin e kërkesës. Pasi KQZ është e bindur që duhet një komitet nismëtar për të regjistruar si kandidatë të pavarur për anëtar të këshillit bashkiak dhe mëandej përjashtohet mbledhja e firmave mbështetëse duke e paraqitur mandatin e këshillit..

Z. L. Braho: Në fakt është udhëzimi nr. 1 i datës 18.01.2023 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve që në nenin 6 regjistrimin e kandidatit për anëtar të këshillit bashkiak të propozuar nga zgjedhësit e lidh me komitetin nismëtar. Pra, në çdo rast edhe mandati thotë duhet të dorëzohet nga komiteti nismëtar, kjo është baza ligjore që referoni ju. Që supozohet që mbështet në nenin 70.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.31.03.2023*


Z. K. Bele: KAS tërhiqet për vendim do ju njoftomë për vendimin, do njoftojmë administratën meqë nuk ka palë.

Rifillon Mbledhja ora 14:41

Z. K. Bele: Riçelim seancën në përfundim të shqyrtimit administrativ duke pasur një diskutim dhe një debat brenda edhe KAS lidhur me interpretimin e nenit 70 të Kodit Zgjedhor dhe konkretisht të faktit nëse do të duhet shumica në rastin e anëtarëve të cilët zotërojnë një mandat, anëtar të Këshillit Bashkiak por nëse do të duhet komiteti nismëtar në këto raste apo jo. KAS në këtë pikë u nda dhe me shumicë votash vendosi të konfirmojë vendimin e KZAZ-së, duke rrezuar ankimin nr. 40 në vendimin nr. 17 në datë 27.03.2023. Kundër këtij vendimi bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës Administrative të Apelit brenda 5 ditëve. Me kaq seancën e deklaroj të mbyllur.

Vendimi nr.38

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.31.04.2023*

**31.04.2023
Ora 14:50**

RENDI I DITËS

Projektakti "Për pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 41, datë 31.03.2023 depozituar nga Partia 'Aleanca e Maqedonasve për Integrim European'".

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Ilirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Z. E. Mema, Znj. I. Osmanaj
- **Parti Politike:**
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. E. Çefa: Çelim seancën paraprake për vlerësimin e elementëve formal të kërkesës ankimore nr. 41 të paraqitur nga Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrimin European. Relator i kësaj çështje pas shortit të hedhur në KQZ jam unë Elvis Çefa. Prezent është trupa e plotë e KAS, nuk ka prezencë të palës kërkuese. Është prezent gjithashtu edhe Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së. Deklarata paraprake në këtë fazë mund të ketë vetëm nga anëtarët e KAS, nuk ka deklarata paraprake. Kështu që nuk kemi pengesë për të vijuar vlerësimin paraprak të kësaj kërkese. Zoti Merkaj fjala për ju!

Z.Y. Merkaj: Faleminderit! Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur kërkesa ankimore nr. 41, me ankues Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrim European. E cila kundërshton vendimin e KZAZ-së nr.71 për mos

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.31.04.2023*

regjistrimin në zgjedhjet vendore të datës 14 Maj 2023 të listës shumemërore të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Bashkisë Pustec të Partisë Aleanca e Maqedonasve për Integrim European. Nga verifikimi paraprakë i kërkesës ankimore konstatohet se është në përputhje me nenin 130 dhe 126 të Kodit Zgjedhor pasi plotëson elementët e formës dhe të përmbatjes. Legjitimimi i ankuesit, kompetenca e KAS dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në përgjithësi dhe afati i ankmit të parashikuar në ligj është brenda afatit. Ju faleminderit!

Z. E. Çefa: Ju faleminderit zoti Merkaj! Ndonjë pyetje nga kolegët? Nuk ka! Atëhere, KAS i konsultuar në vend, vendosi kalimin për shqyrtim të kërkesës ankimore me numër 41 me subjekt kërkues Partia Aleanca Maqedonasve për Integrimin European. Seanca e shqyrtimit të kësaj kërkesë do të bëhet ditën e Hënë në datën 3 Prill në orën 11 e 30. Me kaq kjo seancë deklarohet e mbyllur!

Vendimi nr.39

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*

